

Në kuadër të **Programit të Reformës në Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2026)**, DCAF vazhdoi të avancojë përpjekjet e saj për të forcuar sektorin e zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut, duke promovuar qëndrueshmërinë, vlerat demokratike dhe qeverisjen efektive. Nga janari deri në mars 2025, u implementua një grup të ndryshëm aktivitete, që synonin një gamë të gjerë përfituesish, (përfshirë Parlamentin, Ekzekutivin, sistemin gjyqësor, shoqërinë civile, dhe mediat) për të promovuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe inclusive në reformë.

## REZULTATI II

### MBËSHTETJA PËR KUVENDIN

DCAF vazhdon të mbështesë stafin parlamentar në përmirësimin dhe institucionalizimin e mbikëqyrjes së sektorit të zbulimit dhe sigurisë. Pasi u zhvilluan disa trajnime të synuara, DCAF organizoi **dy punëtori mbi Zhvillimin e një Kuadri për Aftësi Komunikimi, Analize dhe Këshillimi**, që u mbajtën në Veles në 27-28 Janar dhe 24-25 Shkurt 2025. Këto punëtori kishin si qëllim të forconin kapacitetin e stafit parlamentar për të **analizuar në mënyrë efektive informacionet e lidhura me sigurinë, për të ofruar këshilla strategjike dhe për të komunikuar gjetjet e mbikëqyrjes në një mënyrë të qartë dhe bindëse**. Sesionet gjithashtu inkurajuan mësimin nga kolegët dhe shkëmbimin ndërinstitutional të përvojave praktike.

Punëtoritë e stafit parlamentar, janar-shkurt 2025, Veles



## Programi për Reforma në Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2026)

BULETINI NR. 15

JANAR-MARS 2025

### DCAF dhe Q/RSS

[DCAF - Qendra e Gjenezës për Qeverisje me Sektorin e Sigurisë](#) angazhohet për rritje të cilësisë së sigurisë së vendeve dhe popujve në ato vende brenda qeverisjes demokratike, sundimit të ligjit, respektit ndaj të drejtave të njeriut, dhe barazisë gjinore. Që nga themelimi në vitin 2000, DCAF ka kontribuar duke rritur qëndrueshmërinë e paqes dhe zhvillimit përmes ndihmës ofruar shteteve partnere, dhe përmes mbështetjes që palët ndërkombëtare u ofrojnë këtyre shteteve për të rritur cilësinë e qeverisjes në sektorin e sigurisë me reforma gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje të të gjitha palëve. DCAF harton materiale njohurie që janë inovative, promovon normat dhe praktikatat e mira, ofron këshilla ligjore dhe të politikbërjes dhe mbështet ndërtimin e kapaciteteve të palëve që veprojnë në fushën e sigurisë- qofshin ato shtetërore apo jo. DCAF është një nga organizatat kryesore në botë në fushën e qeverisjes me sektorin e sigurisë (QSS) dhe reformat në sektorin e sigurisë (RSS).

Arritjet kryesore dhe kontributi i DCAF-it mund të shihen në [videon](#) më të re. Informacione më të detajuara në lidhje me aktivitetet dhe performancën e DCAF për vitin 2023 ju mund të gjeni në [raportin e fundit](#).

### INTEGRITETI POLICOR

Me përkrahjen e DCAF, zbatimi i **Planit për Integritetin të Ministrisë së Punëve të Brendshme 2023-2025** vazhdon të përparojë. Duke ofruar udhëzime strategjike dhe mbështetje të vazhdueshme, DCAF ka luajtur rol kyç në mbështetje të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të planit. Pas organizimit të një punëtorie nga DCAF nga 30 janari deri më 1 shkurt me qëllim vlerësimin e **vitit të dytë të zbatimit**, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm publikoi raportin e tij të dytë vjetor publik. Ky raport gjithëpërfshirës është i disponueshëm në ueb-faqen e Ministrisë në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze. Duke parë përpara, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm mbetet i përkushtuar për zbatimin e **Planit të Veprimit për vitin 2025**, së bashku me DCAF, i cili do të vazhdojë t'i ofrojë mbështetje në të gjitha fazat e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit.

Vegëza e Raportit:



**AGJENT I NDRYSHIMIT – Miomir Serafinoviq, gazetar**

Nëpërmjet aktiviteteve të DCAF e kam përmirësuar raportimin tim analitik për tema nga fusha e reformave të sigurisë dhe sektorit të sigurisë në përgjithësi, kam kuptuar se si krijohet politika në këtë fushë, veçanërisht në pjesët për parandalimin e abuzimeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. E rëndësishme është se së bashku me DCAF arritëm të krijojmë një grup të fortë - një ekip të vërtetë nga përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, gazetarë, ish të përfshirë në shërbimet e sigurisë me të cilët së bashku arritëm të artikulojmë nevojat e qytetarëve para palëve të prekura: deputetëve, përfaqësuesve të Avokatit të Popullit, gjykatësve dhe prokurorëve. Baza për analizën e informacionit publik ishin përvojat e kolegëve nga punëtoritë dhe feedback-u që mora për raportimin tim mbi nevojën dhe zgjedhjen e Këshillit Civil për mbikëqyrjen e masave të monitorimit të komunikimeve. Dua të theksoj gjithashtu shkëmbimin e opinionëve mbi reformën e propozuar të shërbimeve sekrete dhe përfundimin se ka nevojë për më shumë raportim mbi këtë temë të ndjeshme. **Unë jam #AgjentiI Ndryshimit sepse ndryshimi fillon nga vetja, nga përvojat e tua dhe njohuritë e reja si dhe detajet që i ke përvetësuar.**

Në përputhje me prioritetet programore të DCAF për ndihmën në ndërtimin e kapaciteteve të punonjësve në Ministrinë e Brendshme (MB) për forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe parandalimin më efikas të korrupsionit dhe shkeljeve të integritetit, **më 5 mars 2025** u organizua një diskutim në nivel të lartë në **Tryezë të rumbullakët për Integritetin Policor: rolet dhe përgjegjësitë e drejtuesve policorë**. Në këtë ngjarje u mbledhën ndihmës të Ministrit dhe shefa të Sektorëve të Brendshëm për të diskutuar mbi përgjegjësitë menaxheriale në promovimin e integritetit dhe llogaridhënies. Tryeza e rumbullakët theksoi rëndësinë e lidershit në nxitjen e sjelljes etike, ndarjen e praktikave më të mira dhe avancimin e përpjekjeve në luftën kundër korrupsionit. Si ngjarja e parë e këtij lloji për drejtuesit nga nivele të mesme dhe të larta të MB, vendosi bazën për një platformë vjetore për mbështetje të punës policore profesionale dhe etike.




Tryezë e rumbullakët për integritetin policor, Shkup, mars 2025

**MBËSHTETJE KOMUNITETIT TË SIGURISË DHE ZBULIMIT**

Nga **10 deri më 14 mars 2025**, në Gjevgelijë, DCAF organizoi **trajnim për trajnerë (ToT) për përfaqësuesit e Shërbimit Ushtarak për Siguri dhe Zbulim pranë Ministrisë së Mbrojtjes (ShUSZM)**. Trajnimi rriti aftësitë e stafit të këtij Shërbimi duke forcuar dhe **zgjerruar njohuritë e tyre për metodologjitë e avancuara për mbajtjen e trajnimeve për zbulimin ushtarak dhe qeverisjen e mirë**. Sesionet ishin të shoqëruara me raste të simuluar nga praktika dhe ushtrime simuluese. Pas përfundimit të trajningut të avancuar, trajnerët e trajnuar do të mbajnë dy kurse gjithëpërfshirëse për stafin e këtij Shërbimi duke u mundësuar atyre të aplikojnë aftësitë e reja të fituara në praktikë.



Punëtori për zhvillimin e Raportit Vjetor 2024 për Zbatimin e Planit të Veprimit për Integritet të MPB-së, Ohër, janar 2025



ToT për Stafin e ShUSZM, Mars 2025, Gjevgjeli

## NDËRTIMI I KAPACITETEVE PËR SHKËMBIM AUTOMATIK TË TË DHËNAVE

**Takimi i parë i grupit tematik të punës për zbatimin praktik dhe teknik të Marrëveshjes Prum** nga Konventa për bashkëpunimin policor që u përqendrua në shkëmbimin automatik të të dhënave për regjistrimin e automjeteve u mbajt në **Vjenë nga 26 deri më 28 mars 2025**. Përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme të Maqedonisë së Veriut nga Departamentet për çështje civile dhe Telekomunikacion aktivisht morën pjesë në këtë punëtori dhe prezantuan përparimin, planet dhe nevojat kyçe të shtetit për operacionalizimin e shkëmbimit automatizuar të të dhënave të automjeteve në kuadër të Konventës Prum. Me ndihmën e DCAF, MPB përfundoi të gjitha përgatitjet e nevojshme për t'u lidhur në rrjetin e sigurisë së BE - TESTA-ng. Në koordinim me Ministrinë e re të transformimit digjital që është organi kontakt nacional për DG DIGIT, MPB është e pozicionuar mirë për integrimin në sistem. Rrjeti TESTA-ng mbështet shkëmbimin automatik të sigurt të të dhënave biometrike dhe identifikuesve, përfshirë ADN-në, daktiloskopinë dhe të dhënat e automjeteve.

## Programi për Reforma në Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

*Prill 2021 – Mars 2026*

Në vazhden e arritjeve të fundit, qëllimi i këtij Programi është të vijojë me procesin e reformave demokratike në sektorin e sigurisë në Maqedoninë e Veriut. Strategjia e intervenimit ka për qëllim të sigurojë që shërbimet e zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut funksionojnë siç duhet nën kontrollin dhe mbikëqyrjen aktive demokratike duke luftuar kundër krimeve serioze të organizuara dhe duke frenuar korrupsionin në përputhje me praktikën e mira të llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Ky Program është i strukturuar për të arritur tre rezultate:

**Rezultati I:** Ndryshim dhe plotësim i kornizave ligjore dhe institucionale në sektorin e zbulimit në Maqedoninë e Veriut në përputhje me parimet relevante Euro-Atlantike dhe praktikën e mira të llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

**Rezultati II:** Organe të mbikëqyrjes së jashtme dhe kontrollit fitojnë njohuri dhe forcojnë kapacitetet për të zbatuar mbikëqyrje transparente dhe efektive të aktiviteteve që bën sektori i zbulimit.

**Rezultati III:** Opinioni informohet lidhur me funksionalitetin dhe rezultatet e sistemit të llogaridhënies së sigurisë dhe zbulimit.

**Partnerët për zhvillim:** Zvicra (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim –SDC), Suedia (Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim – Sida), Holanda (Ministria e Punëve të Jashtme) dhe Bashkimi Evropian.

### Partnerët në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

- Kuvendi i Maqedonisë së Veriut
- Zyra e Kryeministrit
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Mbrojtjes
- Shërbimet e sigurisë dhe zbulimit
- Agjencia Teknike Operative (ATO)
- Agjencia për Mbrojtje të të Dhënave Personale
- Drejtoria për Siguri të Informatave të Klasifikuara
- Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë
- Zyra e Prokurorit Publik kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
- Gjykata dhe institucione të tjera gjyqësore
- Avokati i Popullit
- Revizioni i Shtetit
- OJQ-të dhe mediet

Takimi i 1-rë i Grupit të Punës për të Dhënat e Regjistrimit të Automatizuar të Automjeteve, Mars 2025, Vjenë



## PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE

Nga 10 deri më 11 shkurt 2025 në Veles u mbajt punëtori për rishikimin e Planit të Veprimit për Gjininë (PVGJ) të Ministrisë së Mbrojtjes, ku u bashkuan anëtarët e grupeve të punës nga Ministria dhe Ushtria e Maqedonisë së Veriut. PVGJ-ja shërben si një kornizë strategjike dhe paraqet masat, objektivat dhe mekanizmat e përgjegjshmërisë për të promovuar përfshirjen, barazinë dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare. Për shkak të ndryshimeve strukturore të fundit në Ministrinë e Mbrojtjes, punëtorja u përqendrua në rishikimin e disa segmenteve dhe përmirësimin e relevancës praktike të PVGJ-së. Gjithashtu, ofroi një platformë për pjesëmarrësit për të kontribuar në përmirësimin e qartësisë, efektivitetit dhe aplikueshmërisë së dokumentit si një mjet për planifikim dhe marrje vendimesh. DCAF do të vazhdojë të mbështesë Ministrinë në zbatimin e PVGJ-së.

## REZULTATI III

### BASHKPUNIMI ME SEKTORIN GJYQËSOR

Më 12 mars 2025, DCAF promovoi Inicativën hulumtuese të praktikën gjyqësore të lidhur me autorizimin dhe zbatimin e masave të veçanta hetimore (MVH) në Maqedoninë e Veriut. Ky aktivitet u iniciua me kërkesë të Akademisë për gjykatës dhe prokurorë gjatë takimeve të grupit menaxhues të drejtësisë dhe qëllimi i kësaj initiative është të përmirësojë transparencën dhe llogaridhënien gjatë përdorimit të MVH. DCAF mbështeti Akademinë në këto përpjekje dhe ndihmoi në zhvillimin

Punëtori për rishikimin e Planit të Veprimit Gjininë të MM-së, shkurt 2025, Veles



e një metodologjie gjithëpërfshirëse për hulumtim. Ky mjet i rënë dakord nga të dyja palët mundëson analizë sistematike sasiore dhe cilësore të praktikave gjyqësore të bazuara në raste dhe vendime gjyqësore reale. Metodologjia gjithashtu shërben si një kornizë për monitorimin e vlerësimit aktual të autorizimit dhe zbatimit të PIM.

Hulumtimi do të realizohet nga një grup pune i përbërë nga përfaqësues të Akademisë dhe anëtarë të grupit gjyqësor dhe prokurorial. Hulumtimi filloi me grupe fokale me gjyqtarë, prokurorë publikë, përfaqësues nga MPB dhe ekspertë juridikë të cilat u mbajtën nga 24 deri më 25 mars 2025 në Shkup dhe që dhanë input dhe e pasuruan kërkimin me vëzhgime praktike. Si hap i ardhshëm në procesin e hulumtimit, do të organizohen disa punëtori me grupin e punës për analizimin e rezultateve të intervistave dhe analizën e burimeve sekondare të të dhënave rishikimi dhe krahasimi i të dhënave të mbledhura dhe për hartimin dhe përgatitjen e raportit të këtij kërkimi.

Ngjarja fillestare dhe grupet e fokusit për hulumtimin e masave speciale hetimore, mars 2025, Shkup



## PËRMIRËSIMIT TË MBIKËQYRJES CIVILE

DCAF vazhdoi gjithashtu me programin e **Trajnimit të Trajnerëve (ToT)**, i dedikuar për të forcuar aftësitë e përfaqësuesve nga OJQ-të, medias dhe Programit Parlamentar në Maqedoninë e Veriut. Ndërmjet **23-25 Janarit 2025**, u mbajt ToT #5 në Veles i cili përfshinte module të fokusuara mbi teknikat e ruajtjes së mësimi, zërin dhe enunacionin, stilin efektiv të gjuhës dhe komunikimit, gjuhën trupore dhe aplikimin e parimeve rjetoriale për të forcuar qartësinë, bindjen dhe angazhimin e audiencës. Iniciativa ka për qëllim fuqizimin e OJQ-ve dhe profesionistëve të medias me njohuri të avancuara dhe aftësi për të shpërndarë në mënyrë efektive informacionin mbi reformën e sektorit të sigurisë dhe qeverisjen nëpërmjet organizatave dhe rrjeteve të tyre, duke forcuar mekanizmat e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies.

### Mekanizmi i Partnerëve Zhvillimorë për Udhëheqje

Për këtë program u zgjodh mekanizmi i financimit të përbashkët dhe deri në dhjetor 2021 kanë kontribuar katër Partnerë Zhvillimorë. Këta janë Zvicra (rreth CHF 1'500'000), Suedia (rreth CHF 1'310'000), Holanda (CHF 780'000), dhe Bashkimi Evropian (rreth CHF 320'000). Bashkë me kontributin vetanak të DCAF-it dhe mbështetjen me mjete jofinanciare nga partnerët përfitues, pra me sigurimin e zyrave, vendtakimeve, pajisjeve teknike, transportin lokal, dhe ekspertët, buxheti i përgjithshëm për periudhën 2021-2026 arrin rreth CHF 5'750'000.

Ky Program udhëhiqet nga grupi i Komisioneve Udhëheqëse me partnerë të vendit përfitues dhe nga Grupi Udhëheqës i Partnerëve Zhvillimorë (GUPZH). GUPZH përbëhet nga Ambasadorët dhe ekipi i programit i nivelit të lartë. Ata angazhohen në mënyrë aktive me Programin duke ofruar këshilla politike dhe strategjike, këshilla për zbatime të reziqeve dhe efektivitet në zbatim. Takimet e GUPZH mbahen një herë në tre muaj dhe organizohen nga misionet e Partnerëve Zhvillimorë me rotacion.

ToT #5 për OSHC-të, mediat dhe kanalin parlamentar, janar 2025, Veles



## MBESHTETJA PËR ZYREN E AVOKATIT TË POPULLIT

Midis **10-11 Shkurt 2025** në Veles, u mbajt **punëtori për Zhvillimin e Listës Kontroll për Kryerjen e Vizitave të Mbikëqyrjes nga ana e këtij institucioni**. Ngjarja ofroi pjesëmarrësve njohuri krahasuese, mjete praktike dhe ushtrime interaktive për të përmirësuar kuptimin dhe kapacitetin e tyre për mbikëqyrje efektive, duke përfshirë zhvillimin e procedurave të brendshme dhe simulimin e praktikave reale të mbikëqyrjes. Kjo punëtori u përqendrua në **strukturimin dhe përfundimin e një mjeti të standardizuar për të udhëhequr dhe përmirësuar efektivitetin e vizitave të mbikëqyrjes nga Avokati i Popullit në Maqedoninë e Veriut**.

Punëtori e Ombuds-it, Shkurt 2025, Veles



Pasi të përfundohet, lista kontroll do të jetë e destinuar të shërbejë si një kuadër praktik për të siguruar që të gjitha aspektet kritike të mbikëqyrjes të trajtohen sistematikisht. WGjithashtu lehtësoi diskutimet midis ekspertëve dhe palëve të interesit për të siguruar që lista kontroll të përputhej me mandatet ligjore, nevojat operative dhe standardet globale për mbikëqyrje dhe qeverisje.

Punëtorja e Ombuds-it, Shkurt 2025, Veles



## AKTIVITETET E RRADHËS PRILL - QERSHOR 2025

- Punëtori mbi Informacionin e Klassifikuar #1
- Punëtori shumë-palësh #4 për deputetët dhe OJQ-të/Media mbi Kontrollin Pas-Ligjor
- Punëtori shumë-palësh #5 për deputetët dhe OJQ-të/Media
- Punëtori për Aftësitë e Komunikimit dhe Konsulencës për deputetët dhe stafin parlamentar
- Punëtori & Intervista me Gjyqtarët dhe Prokurorët mbi Analizën e Hulumtimeve mbi MVH-të
- Vizitë pune në Akademinë e Drejtësisë së Turqisë
- Punëtori mbi Menaxhimin e Projekteve dhe Buxhetimin për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë
- Punëtori e Parë mbi Analizën e Kërkimeve mbi MHV-të
- Punëtoritë mbi Planifikimin Strategjik dhe Komunikimin për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë
- Takimi vjetor me Departamentet e Forenzikës mbi aktivitetet në vazhdim dhe Shkëmbimin e të Dhënave digjitale
- Promovimi i Raportit të Vetëvlerësimit Gjnor dhe Planit të Veprimit
- Transmetimi i Mini-Dokumentarit mbi Procesin e Vetëvlerësimit Gjnorë
- Punëtori për Zhvillimin e Kornizës së Vlerësimit, Monitorimit dhe Raportimit për Planin e Veprimit Gjnor
- Punëtorja #1 për Përmbledhjen e Kurrikulës për Studime të Specializuara Profesionale, UGD Shtip
- Punëtori e përbashkët ndërmjet UGD-së dhe OJQ-ve /grupit mediatik: Të dhëna nga OJQ-të/media

**NA GJENI, NA NDIQNI:**

